



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1613 Prot.

Tiranë, më 22.11.2021

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për përjashtimin e kategorisë së personave me sindromën down dhe personave me çrregullime të spektrit autik, nga pagimi i detyrimeve doganore të importit, për mjetet në pronësi të tyre.

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4

Tiranë

KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3

Tiranë

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Rruga e Kavajës, Nr. 1001

Tiranë

INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Rruga e Durrësit, Nr. 83

Tiranë

SHERBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Rruga e Durrësit, Nr. 83

Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Kashar Mëzez, Lagjja Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Qendra “Pajtoni Bussines Center”, kati 5

Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Rruga: "Muhedin Llagani", Nr. 10

Tiranë

Për dijeni: **KLUBIT KOMBËTAR TË PRINDËRVE TË FËMIJËVE ME ÇRREGULLIME TË SPEKTRIT AUTIK (ÇSA)**
Rruga: "5 Maji", Nd. 130, H. 3, Ap. 4
Tiranë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar², si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi, si dhe çdo formë sjelljeje që e nxit atë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa "f", të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar (LMD), përcaktohet se: "*Komisioneri ka kompetencë ... të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin*".

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa "c", të LMD, ku përcaktohet se: "*Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji*", si dhe bazuar në informacionin e marrë nga Klubi Kombëtar i Prindërve të Fëmijëve me Çrregullime të Spektrit Autik (ÇSA); Komisioneri, në ushtrim të kompetencës që i jep LMD, me Urdhrin nr. 11, datë 18.01.2021³, ka filluar procedurat ndjekjen kryesisht të çështjes së kategorisë së personave me aftësi të kufizuara (AK), lidhur me kërkesën për përjashtimin nga detyrimi doganor për importin e mjeteve që u përkasin personave me AK.

I. Parashtrimi i fakteve sipas Klubit Kombëtar të Prindërve të Fëmijëve me Çrregullime të Spektrit Autik

Referuar parashtrimeve të sjella nga Klubi Kombëtar i Prindërve të Fëmijëve me Çrregullime të Spektrit Autik (ÇSA), ndër të tjera, citohet se: "*Nga kërkimet e deritanishme që ne kemi kryer si organizatë na rezulton se personat me aftësi të kufizuara janë të gjithë të përjashtuar nga taksa e*

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

³ Urdhër nr. 11, datë 18.01.2021 "*Për fillimin e procedurave për ndjekjen "ex officio" të çështjes së kategorisë së personave me aftësi të kufizuara (AK), lidhur me kërkesën për përjashtimin nga detyrimi doganor për importin e mjeteve që u përkasin personave me AK*".

regjistrimit të automjetit, por nuk ndodh e njëjta gjë përsa i përket doganës. Nga verifikimet tona rezulton se vetëm personat paraplegjikë të grupit të parë dhe automjetet e ambasadave janë të përjashtuar nga tarifat doganore të mjeteve. Organizata jonë vlerëson dhe ka në fokus jo vetëm pagesën apo asistencën ekonomike, por mbi të gjitha gjithëpërfshirjen e personave AK. Ne mendojmë se transporti është një komponent shumë i rëndësishëm që lidhet ngushtë me jetesën e pavarur dhe rrit mundësinë për një përfshirje më aktive sociale, në përputhje të plotë me parashikimet ligjore të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe ligjit nr. 93/2014 “Për përshatjen dhe Aksesueshmërinë”, ku transporti vlerësohet si një e drejtë themelore e njeriut”.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në lidhje me pretendimin e paraqitur, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 122/1 prot., datë 19.01.2021, ka kërkuar informacion nga ana e: Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Shërbimit Social Shtetëror (SSHS), Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).

Nëpërmjet shkresave respektive, subjektet sipërcituar kanë sjellë parashtrimet dhe qëndrimin e tyre lidhur me problematikën e parashtruar nga Klubi Kombëtar i Prindërve të Fëmijëve me Çrregullime të Spektrit Autik (ÇSA).

- Nëpërmjet shkresës me nr. 1160/1 prot., datë 28.01.2021, DPSHTRR ka informuar Komisionerin se:

“DPSHTRR dispon informacion statistikor lidhur me pronarët e mjeteve, të cilët janë me aftësi të kufizuar dhe që bazuar në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, dhe në Udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, të MF, përfitojnë përjashtimin nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura “...autovetura tip deri në 4+1 vende dhe me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verëbërve, individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për veprimtari private. Përjashtimi nga pagimi i taksës bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të veteranit të luftës, i invalidit të punës a të luftës, të verbërit, të sënurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Veterani i luftës, invalidi i luftës apo i punës, personat e verbër, si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të paraqesin pranë agjentit tatimor librezën përkatëse, së bashku me

dokumentin e identifikimit të personit që përfiton përjashtimin nga taksa dhe vërtetimin që nuk kryen veprimtari ekonomike”.

Nga të dhënat e statistikave për 3 vitet e fundit, lidhur me numrin e personave me aftësi të kufizuar, të cilët përfitojnë përjashtimin nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura, rezulton se:

- Për vitin 2018 janë përjashtuar gjithsej 12,610 persona me AK.
 - Për vitin 2019 janë përjashtuar gjithsej 14,451 persona me AK.
 - Për vitin 2020 janë përjashtuar gjithsej 16,745 persona me AK.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 116/1 prot., datë 29.01.2021, SHSSH ka informuar Komisionerin se:

“SHSSH pajis me librezë për statusin, kategorinë e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të verbër dhe persona me AK (mendore, fizike e shqisore).

Në lidhje me listën e personave që bëjnë pjesë në kategorinë e mësipërme dhe kanë në zotërim një automjet rrugor të cilin e përdorin vetëm për nevojat e tyre personale, SHSSH, nuk disponon një bazë të dhënash për automjetet në zotërim të tyre.

Në zbatim të VKM nr. 387, datë 31.05.2001 “Për përjashtimin nga taksat dhe tatimet të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë” dhe Udhëzimit të Përbashkët midis Administratës së Përgjithshme të SHSSH me nr. 75/6 prot., datë 22.04.2011 dhe DPD me nr. 5608/6 prot., datë 22.04.2011 “Mbi procedurat e përjashtimit nga detyrimet doganore të importit për mjetet që u përkasin të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, SHSH, pajis me vërtetim për përjashtimin nga detyrimet doganore të importit për mjetet e përdorura në pronësi vetëm personat e kategorisë së invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë”.

SHSSH ka dërguar të dhënat statistikore për periudhën 2015-2020, si më poshtë pasqyrohen:

Lista e personave me AK:

Periudha 2015-2020	Persona me AK total	Me status verbërie	Me status para- tetraplegjikë	PAK të tjerë (mendore, fizike e shqisore)
2015	66,691	12,247	6,341	48,103
2016	66,854	12,193	6,310	48,351
2017	67,056	12,107	6,358	48,591
2018	68,544	12,124	6,494	49,926
2019	71,032	12,400	6,666	51,967
2020	73,200	12,185	6,549	54,466

Lista e personave invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë që kanë përfituar nga SHSSH vërtetime për përjashtimin nga detyrimet doganore të importit për mjetet në pronësi të tyre:

Periudha 2015-2020	Vërtetime për përjashtim nga detyrimet doganore të importit për mjetet e përdorura në pronësi të invalidëve
2015	26
2016	28
2017	24
2018	31
2019	14
2020	24

- Nëpërmjet shkresës me nr. 458/1 prot., datë 29.01.2021, ISSH ka informuar Komisionerin se:

“ISSH administron dhe drejton sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Po ashtu, bazuar në ligjin nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, ISSH, trajton me përfitime invalidët e punës, të cilët kanë paguar sigurime shoqërore, sipas ligjit sipërcituar.

...Përjashtimi i një kategorie të caktuar nga detyrimet doganore apo tatimore mund të bëhet vetëm me ligj të veçantë, i cili propozohet nga institucioni përkatës që trajton kategorinë e përfituesve, sipas fushës së tij të kompetencës”.

ISSH ka dërguar të dhënat statistikore lidhur me numrin e personave me AK, të cilët përfitojnë pension invaliditeti, për periudhën 2015-2019, si më poshtë pasqyrohen:

Pensione invaliditeti	2015	2016	2017	2018	2019
Nga sëmundje të përgjithshme	67,059	66,620	66,970	67,466	67,819
Nga aksidentet në punë dhe sëmundje profesionale	2,802	2,771	2,743	2,706	2,679
Për një mbrojtje të veçantë të	3	3	3	3	3

ushtarakut					
Total	69,864	69,394	69,716	70,175	70,501

- Nëpërmjet shkresës me nr. 1314/1 prot., datë 22.02.2021, DPD ka informuar Komisionerin se:

“Personat AK që përjashtohen nga detyrimet e importit të automjeteve të përdorura në pronësi të tyre, apo pajisjeve të tjera lëvizëse, duhet të jenë paraplegjikë ose tetraplegjikë, dhe se automjetet që përfitojnë nga përjashtimi duhet të jenë me fuqi deri në 2.5 cc, sipas përcaktimit të pikës 6, të Udhëzimit nr.1, datë 03.01.2018 “Mbi operacionet e privileguara”, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD”.

III. Legjislacioni i zbatueshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.
2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 16

1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëjloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.
2. Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve.

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 59

Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

- a) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;
- b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;
- c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;
- ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë;
- d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
- dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;
- e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;
- ë) zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse;
- f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;
- g) mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

Neni 122

1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.
2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. 33
3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut⁴ (KEDNJ)

Neni 14

“Ndalimi i diskriminimit”

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindaj ose çdo status tjetër.

Protokolli 12, KEDNJ

Neni 1

“Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit”

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindaj ose çdo status tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar⁵

Neni 1

“Qëllimi”

Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë, mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore aftagjata të cilat në ndërveprim me barrierat të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

Neni 2

“Përkufizimet”

Në kuptimin të kësaj Konvente:

“Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar” ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore

⁴ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

⁵ Shqipëria e ratifikoi KDPAK në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të që prej 11 Shkurtit 2013.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës”.

Neni 3

“Parime të përgjithshme”

Parimet e kësaj Konvente do të përfshijnë:

- (a) Respektin për dinjitetin, autonominë individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit;
- (b) Mosdiskriminimin;
- (c) Pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri;
- (d) Respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;
- (e) mundësi të barabarta;
- (f) Akses;
- (g) Barazi ndërmjet burrave dhe grave;
- (h) Respekt për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si edhe respektimi i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetin e tyre.

Neni 4

“Detyrime të përgjithshme”

1. Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe nxisin realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pa diskriminim të ndonjë lloji për shkak të aftësisë së kufizuara. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin përsipër:

- (a) Të miratojnë të gjitha masat e duhura legjislative dhe administrative, si dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga kjo Konventë;
- (b) Të marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legjislative për të modifikuar apo shfuqizuar ligjet, rregulloret, zakonet dhe praktikatat ekzistuese, të cilat kanë përmbajtje diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara;
- (c) Të marrin parasysh mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha politikatat dhe programet;
- (d) Të mos marrin pjesë në veprime apo praktika që nuk janë në përputhje me këtë Konventë dhe të sigurohen që autoritetet dhe institucionet publike veprojnë në përputhje me këtë Konventë;
- (e) Të marrin të gjitha masat e duhura...

3. Në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit për zbatimin e kësaj Konvente, si dhe për proceset e tjera vendim-marrëse në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara. Shtetet Palë duhet të konsultohen në mënyrë aktive me personat me aftësi të kufizuara, përfshirë

këtu edhe fëmijët me aftësi të kufizuar për të siguruar përfshirjen e tyre nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese.

4. Asgjë nga kjo Konventë nuk duhet të prekë ato dispozita, që janë më të favorshme për realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe që mund të përmbahen në ligjin e Shtetit Palë apo ligjin ndërkombëtar në fuqi për atë Shtet. Nuk duhet të ketë asnjë kufizim apo cënim të asnjë prej të drejtave të njeriut dhe lirive themeltare të njohura apo ekzistuese në cilindo Shtet Palë në këtë Konventë në përputhje me ligjin, konventat, rregulloret apo zakonet me pretekstin se kjo Konventë nuk i njeh këto të drejta apo liri, apo se ajo i njeh ato në një masë më të vogël.

Neni 5

“Barazia dhe mosdiskriminimi”

1. Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.
2. Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimii për shkak të aftësisë së kufizuar dhe t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuar mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në cdo rrethanë.
3. Me qëllim nxitjen e barazisë dhe eliminimin e diskriminimit, Shtetet Palë duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura për tu siguruar se është ofruar akomodim i arësyeshëm.
4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur *de facto* barazinë e personave me aftësi të kufizuar nuk do të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj Konvente.

Neni 9

“Aksesi”

1. Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar, ashtu si gjithë të tjerë të kenë akses në ambjentet fizike, ndaj transportit, informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në facilitete apo shërbime të tjera të disponueshme apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat do të përfshijnë evidentimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave ndaj aksesit do të zbatohen ndër të tjera: 11
- (a) Në ndërtesa, rrugë, transport dhe facilitete të tjera në ambjente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, qendrat shëndetësore apo ambjentet e punës...

Neni 19

“Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet”

Shtetet Palë në këtë Konventë njohin të drejtën e barabartë të të gjithë personave me aftësi të kufizuar për të jetuar në komunitet, me zgjedhje të barabarta me të tjerët dhe do të marrin masat e duhura dhe efektive për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht këtë të drejtë dhe përfshirjen e pjesëmarrjen e tyre të plotë në komunitet...

Neni 20

“Lëvizshmëria personale”

Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të siguruar lëvizshmërinë personale me pavarësinë më të madhe të mundshme për personat me aftësi të kufizuar, si më poshtë:

(a) Lehtësimin e lëvizshmërisë personale të personave me aftësi të kufizuar sipas mënyrës dhe kohës zgjedhur prej tyre, dhe me kosto të përballueshme;

(b) Lehtësimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuar në mjetet levizëse, paisjet, teknologjitë asistive/ndihmese dhe format e asistencës direkte dhe të ndërmjetme, përfshirë sigurimin e tyre me kosto të përballueshme...

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar

Neni 1

“Objekti”

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër

Neni 2

“Qëllimi”

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;

b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;

c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Neni 3

“Përkufizimet”

1. “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura

nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

9. “*Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme, që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore, të njohura në kuadrin ligjor kombëtar, për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 20

“Të mirat dhe shërbimet”

1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

Neni 22

“Statusi”

Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 32

“Kompetencat”

1. Komisioneri ka kompetencë:

...c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;

...ë) t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;

Ligji nr. 93/2014 “Për Përshtatjen dhe Aksesueshmërinë”, i ndryshuar

Neni 1

Objekt i këtij ligji janë:

- a) përcaktimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerët;
- b) përcaktimet për garantimin e jetesës së pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që zgjedhin të jetojnë në mënyrë të pavarur, duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe vendimmarrjen e pavarur, me synimin për të garantuar jetën në komunitet në kushte të barabarta me të tjerët;
- c) përcaktimet për mënyrën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, nevojave për mbështetje të personave me aftësi të kufizuara dhe mënyrat se si do të sigurohet kjo mbështetje.

Neni 2

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;
- b) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

Neni 3

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve. 3. “Pengesat” nënkupton: ...ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.

Neni 4

Parimet bazë të këtij ligji janë:

- a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë; ç) garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimi të pengesave të të gjitha llojeve;

Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Neni 1

“Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore”

Ligji për sigurimet shoqërore të Republikës së Shqipërisë rregullon marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore.

Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore përbëhet nga:

- a) sigurimet shoqërore të detyrueshme;

- b) sigurimi shoqëror vullnetar;
- c) sigurimi shoqëror suplementar;
- ç) pensionet shtetërore të posaçme;
- d) pensionet sociale;
- dh) fondet profesionale dhe fondet e pensionit vullnetar.

Neni 2

“Sigurimet shoqërore të detyrueshme”

Sigurimi shoqëror i detyrueshëm është jofitimprurës, që mbron me të ardhura:

- a) Personat e punësuar në lidhje me:
 - paaftësinë e përkohëshme në punë për shkak të sëmundjes;
 - barrë lindjen;
 - pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes;
 - aksidentin në punë dhe sëmundjet profesionale;
 - papunësinë.
- b) personat e tjerë ekonomikisht aktivë (punëdhënësi dhe të vetëpunësuarit), në lidhje me:
 - barrë lindjen;
 - pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes.

Neni 35

“Kushtet e përfitimit”

1. Personi që bëhet i paaftë merr pension invaliditeti, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit dhe për çdo arsye, veç aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale. Ai e merr këtë pension kur bëhet i paaftë:

- a) për çdo veprimtari ekonomike;
- b) kur ka gjyftime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin).

Invaliditeti caktohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

Në vendimin e tij shënohen shkaqet e invaliditetit, koha e fillimit të tij, si dhe shkalla e humbjes së aftësisë në punë.

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve Eprore caktohen me këtë Ligj.

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve të nivelit të parë caktohen me Rregullore të ISSH-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12muaj sigurim shoqëror.

Personi, që është në kushtet e invaliditetit të plotë, por që nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit, ka të drejtë për pension invaliditeti të reduktuar, në masën që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti;

3. Personi që përfiton pension për invaliditet, kur plotëson moshën, ka të drejtë të kërkojë pension pleqërie, nëse ky do të jetë më i favorshëm për të.

Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore;
- b) të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre;
- c) të garantojë asistencë sociale nëpërmjet ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura;
- ç) mirorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale.

Neni 4

“Përkufizime”

- i) “Komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar”, është një ekip i përzgjedhur, i përbërë nga një mjek dhe një punonjës social, të cilët janë të punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe janë përgjegjës për kryerjen e vlerësimit bio-psiko-social të aplikuesve për përfitimet në para dhe/ose në natyrë për shkak të aftësisë së kufizuar, bazuar në dokumentet e përgatitura nga institucionet shëndetësore, informacionin e marrë nga intervistat e zhvilluara, verifikimin dhe shkëmbimin e informacionit me institucione të tjera sociale, arsimore, shëndetësore, të punësimit e formimit profesional;
- n) “Person me aftësi të kufizuar”, janë individët, të cilët kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime, që, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore e të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të tyre në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët, siç përkufizohet në legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar;

Neni 5

“Parime të përgjithshme”

- d) mosdiskriminimi është parimi që përcakton të drejtat që burojnë nga ky ligj pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër;

Neni 6

“Asistenca sociale”

Asistenca sociale përfshin, por nuk kufizohet në, ndihmën ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar, ndihmën e menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe përfitime të tjera, që garantohen nga ky ligj.

Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidëve të Punës”, i ndryshuar

Neni 1

Statusin e invalidit e gëzon personi i aksidentuar në punë, i sëmurë nga sëmundje profesionale ose sëmundje të ndryshme, që përfiton pension invaliditeti nga sistemi i sigurimeve shoqërore, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionin e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore", i ndryshuar dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

Neni 2

Shoqëria dhe shteti marrin në mbrojtje invalidët, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, t'u sigurohet niveli ekonomik i nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, të kenë kushte banimi, të shfrytëzojnë mjedisin e jashtëm, të kenë një punë të përshtatshme, si dhe t'u krijohen mundësi normale për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse e argëtuese.

Neni 8

1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron pajisjen e invalidëve me:

- a) mjete lëvizëse përfshi dhe autovetura dhe pajisje të ndryshme ortopedike;
- b) me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale;
- c) me mjete ndihmëse kardiale etj.

Kriteret përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2. Invalidët nuk paguajnë taksa doganore për mjetet lëvizëse dhe ndihmëse të përcaktuara në pikat a,b dhe c të pikës 1 të nenit 8.

Neni 16

- 1. Invalidët përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta të parashikuara në ligjin nr. 7680, datë 3.3.1993 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.
- 2. Kur invalidi ushtron veprimtari private, nuk përjashtohet nga taksat.

Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar

Neni 9

“Përjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare”

1. Përrjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura:

ç) autoveturat tip deri në 4+1 vende dhe me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse, dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private;

Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar

Neni 3

Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes. Kur këto përbëjnë vepër penale, iniciativën për fillimin e çështjes penale, përveç kujdestarit e ka edhe organi i prokurorisë apo organizata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose përkujdeset për ta.

Neni 4

Të verbërit përjashtohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur ata kryejnë veprimtari private si persona juridikë.

Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, i ndryshuar

Neni 4

Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjeve.

Neni 6

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta. Në rastet kur ata vetëpunësohen si persona fizikë dhe janë subjekte të tatimit mbi biznesin e vogël, kuota e tatimit fiks është sa gjysma e asaj të përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

VKM nr. 378, datë 31.05.20011 “Për përjashtimin nga taksat dhe tatimet të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë”

Përjashtohen nga detyrimet doganore të importit për mjete me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, mjetet që janë në pronësi të të sëmurëve paraplegjikë ose tetraplegjikë.

Udhëzimi i Përbashkët midis Administratës së Përgjithshme të SHSSH me nr. 75/6 prot., datë 22.04.2011 dhe DPD me nr. 5608/6 prot., datë 22.04.2011 “Mbi procedurat e përjashtimit nga detyrimet doganore të importit për mjetet që u përkasin të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë”

1....Përfitues të përjashtimit nga detyrimet doganore të importit janë:

- a) Të sëmurët paraplegjikë
- b) Të sëmurët tetraplegjikë

4. Përjashtohen nga detyrimet doganore të importit mjetet e të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë.

Udhëzim nr.1, datë 03.01.2018 “Mbi operacionet e privileguara”, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD”

6. Mallrat që importohen nga invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë

Objekti i përjashtimit: Pajisje, karroca, përfshirë autovetura , deri në 2500 kubikë, të përshtatura për përdorimin e tyre, në pronësi të invalidit paraplegjik ose tetraplegjik.

Udhëzim nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, i Ministrisë së Financave

Përjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura:

...

c) autoveturat tip 4+1 vende dhe me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për veprimtari private.

Përjashtimi nga pagimi i taksës bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të veteranit të luftës, invalidit të punës a të luftës, të verbrit, të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

IV. Arsyetimi ligjor

Në përfundim të analizës së legjislacionit, rezultoi se:

Qëllimi i përbashkët i këtyre akteve ligjore dhe nënligjore është që nëpërmjet tyre të nxitet, mbrohet dhe të sigurohet që, të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Nga analizimi i legjislacionit shqiptar lidhur me lehtësirat që parashikohen për përjashtimin nga pagesa e taksës të importit të mjeteve që u përkasin disa kategorive specifike të personave me

aftësi të kufizuara, janë përfshirë specifikisht, kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, të: invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Komisioneri vlerëson marrjen e këtyre masave pozitive dhe lehtësirat në legjislacion lidhur me përfitimet për kategoritë sipërcituar, në mënyrë që atyre t'u sigurohet një shërbim e trajtim i përshtatshëm dhe dinjitoz, por thekson se, e njëjta frymë duhet të ekzistojë edhe përsa i takon personave me sindromën down dhe personave me çrregullime të spektrit autik.

Nuk rezulton të ketë parashikime ligjore për përfitim lehtësirash për sa më sipër, për kategoritë e personave me sindromën down dhe për personat me çrregullime të spektrit autik, të cilët kanë në pronësi të tyre një automjet për përdorim vetiak.

Referuar përkufizimit të gjithëpranuar për termin “persona me aftësi të kufizuar”, është përcaktuar se, *“personat me aftësi të kufizuara” përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërvëprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.*

Lidhur me sa më lart, përcaktimin nëse një individ është person me aftësi të kufizuar, e bën Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë së Kufizuar (KMCAP) ose Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (KSHVAK), bazuar pikërisht në dëmtimet fizike, intelektuale apo shqisore të tyre.

Në këtë kontekst, tek personat me sindromën down dhe personat me çrregulime të spektrit autik, hyjnë ato persona që janë diagnostikuar dhe vlerësuar si të tillë nga KMCAP ose KSHVAK përkatëse.

Referuar publikimeve⁶ të bëra nga Fondacioni Down Syndrome Albania, në bashkëpunim me departamentin e Shërbimit Social Shtetëror, evidentohen statistikat e plota të individeve me sindromën down që janë pjesë e skemës së Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Aktualisht, në Shqipëri, sipas kesaj skeme jetojnë 643 persona me sindromën down.

Ndërsa, për personat me çrregulime të spektrit autik nuk rezulton të ketë të statistika apo të dhëna të tjera ku të evidentohet numri i saktë i tyre.

Pavarësisht se, personat me sindromën down dhe personat me çrregulime të spektrit autik, bazuar në vërtetimet e komisioneve të specializuara, sipërcituar, bëjnë pjesë tek kategoritë e personave me AK, nga analiza e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, nuk rezulton që ata të jenë të përfshirë në parashikimet që këto akte kanë bërë për kategoritë e personave me AK, specifikisht: individëve

⁶ <https://www.dsalbania.org/index.php/sindroma-down-2/statistikat-ne-shqiperi>.

që gëzojnë statusin e e invalidit të punës, statusin e personave të verbër, paraplegjik/tetraplegjik apo të veteranit të luftës antifashiste.

Nga analizimi i legjislacionit, rezulton që, kategoria e personave me sindromën down dhe personave me çrregullime të spektrit autik, të cilët zotërojnë një automjet në pronësi të tyre, janë vënë në pozita të pafavorshme dhe të pabarabarta, në krahasim me kategoritë të cilat përfitojnë lehtësi lidhur me përjashtimin nga pagesa e taksës të importit të mjeteve që u përkasin atyre, pikërisht nga mosparashikimi i një fakti të tillë në aktet ligjore dhe nënligjore specifike.

Përjashtimi i kësaj kategorie nga e drejta e përfitimit të mundësisë për mospagesën e detyrimeve doganore të importit për mjete me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, në pronësi të tyre; i privon ata nga e drejta për garantimin e një pavarësie më të madhe në lëvizje.

Ky fakt, bie ndesh edhe me parimin e mosdiskriminimit, në ligjin nr. 93/2014 *“Për përshtatjen dhe Aksesueshmërinë”*, të ndryshuar, ku termi “aksesueshmëri” përcakton mënjanimin e pengesave të të gjitha llojeve, përfshirë edhe pengesat institucionale: ato në legjislacion dhe në politikat e ndryshme hartuar në ndihmesë të personave me AK.

V. Konkluzione

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t’u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëllor si të tjerët, si dhe mundësisht t’u garantohet jetesë e pavarur. Mundësia e posedimit të një automjeti, nga ana e personave me aftësi të kufizuara, është një element i rëndësishëm në garantimin e jetesës së pavarur të tyre.

Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të individëve, duhet të sigurohet që t’i ofrojnë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme.

Referuar parashikimeve specifike në legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria, legjislacionin e brendshëm, si dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare; barazia dhe mosdiskriminimi i personave me aftësi të kufizuara, duhet kuptuar jo vetëm midis personave me aftësi të kufizuara dhe personave të tjerë, por dhe midis llojeve e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

Sa më sipër, Komisioneri konstaton se, ka një diferencë në trajtim të personave me aftësi të kufizuara që iu është kufizuar aftësia si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, të intelektit psikikomendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme ose të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin dhe që nuk gëzojnë statusin e invalidit të punës, të personit të verbër, paraplegjik/tetraplegjik apo të veteranit të luftës

antifashiste kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar⁷. Kjo diferencë në trajtim vjen për shkak të llojit të aftësisë së kufizuar.

Grupi i individëve të kategorizuar me çrregullime të spektrit autik dhe sindromën down, rezulton se trajtohen në mënyrë më pak të favorshme, pasi nuk gëzojnë të njëjtat lehtësira lidhur me përjashtimin nga detyrimet doganore të importit për mjete me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, në pronësi të tyre, që legjislacioni në fuqi garanton për grupin e personave që kanë statusin e invalidit të punës, të personit të verbër, paraplegjik/tetraplegjik apo të veteranit të luftës antifashiste.

Në këtë këndvështrim, këta individë janë vendosur në kushte më pak të favorshme për të siguruar jetesën e pavarur, si një parakusht për të gëzuar të drejta dhe liri të tjera, në raport me grupin e individëve me aftësi të kufizuara që gëzojnë të drejtën për të përfituar nga përjashtimi i taksës doganore të importit të automjeteve të përdorura në pronësi të tyre.

Materializimi i shumë të drejtave për individët, bëhet pikërisht nëpërmjet hartimit dhe miratimit të ligjeve dhe akteve nënligjore nga ana e qeverisë.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre. Ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor⁸.

Bazuar në sa më lart, Komisioneri vlerëson se, me qëllim eliminimin e situatës diskriminuese për kategorinë e personave me sindromën down dhe çrregullime të spektrit autik, që nuk gëzojnë statusin e e invalidit të punës, të personit të verbër, paraplegjik/tetraplegjik apo të veteranit të luftës antifashiste, është e nevojshme, ndërmarrja e iniciativës për hartimin dhe miratimin e legjislacionit që do të mundësonte gëzimin e së drejtës për të përfituar përjashtimin nga taksa doganore e importit të automjeteve në pronësi të tyre, në raport me kategoritë e tjera të personave me aftësi të kufizuara që e përfitojnë atë në bazë të parashikimeve në legjislacionin përkatës.

Komisioneri vlerëson se, për të garantuar në mënyrë efektive barazi në trajtimin e këtyre kategorive të personave me aftësi të kufizuara, duhet që kuadri ligjor të plotësohet me hartimin e miratimin e akteve të posaçme ligjore apo nënligjore, lidhur me të drejtën e tyre për të të përfituar përjashtimin nga taksa doganore e importit të automjeteve në pronësi të tyre, njëlloj si kategoritë përfituese, si dhe masat duhet të ndërmerren në një kohë sa më të shpejtë.

⁷ Në këtë kategori bëjnë pjesë edhe individët e diagnostikuar nga komisionet e posaçme mjeko-ligjore, me çrregullime të spektrit autik.

⁸⁸ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

Sa më sipër, me qëllim rregullimin e situatës, si dhe bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja “f”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

REKOMANDON:

1. Marrjen e masave për hartimin dhe miratimin e akteve ligjore apo nënligjore, lidhur me përfshirjen e kategorisë së personave me aftësi të kufizuar me sindromën down dhe çrregullime të spektrit autik që kanë në pronësi të tyre një automjet, në kategoritë përfituese të personave me AK, të cilët përjashtohen nga detyrimet doganore të importit për mjete me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, në pronësi të tyre, me qëllim sigurimin e trajtimit të tyre në mënyrë të barabartë e të padiferencuar, me kategoritë e tjera të personave me AK që rezultojnë përfitues në bazë të akteve konkrete ligjore dhe nënligjore.
2. Lutemi brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, përcjelljen e informacionit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi apo çdo informacion tjetër që ka rëndësi lidhur me këtë çështje.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime

Shkaku: Aftësia e kufizuar